

të qëllonin me armë zjarri mbi ta. Viktimat binin njëra mbi tjetrën. Policia e ka mbajtur *Mëshallën Ahmeti* të bllokuar tërë natën. Në aksion ishin të angazhuar më tepër se 200 pjesëtarë të policisë. Në datën 1.03.1998, nga ora 10:00, nga Prishtina/Priština në Likoshan/Likošane ka arritur ekipi për hetime: gjykatësja hetuese e Gjykatës së Qarkut, Danica Marinković, dhe zëvendësi i Prokurorit të Qarkut, Jovica Jovanović. Disa burra ende jepnin shenjat e jetës. Atyre nuk u dha kurrfarë ndihme, por policët i ekzekutonin me armë zjarri ata që ende ishin të gjallë. Kufomat e viktimave u transferuan në Institutin për Mjekësinë Ligjore të Qendrës Spitalore në Prishtinë/Priština. Fshati ishte i bllokuar deri në ora 15:00, në datën 1.03.1998. Xheveti, më në fund, kishte mundësi të hynte në shtëpinë e vet vetëm pas orës 15:00. Jashtë oborrit, ka gjetur dhëmbë të thyer, fije të flokut dhe një-olla të shumta gjaku. Në mbrëmjen e datës 1.03.1998, ai ka mësuar nga Kadri Gjeli se kufomat e burrave të familjes Ahmeti, si dhe ai i Behramit, gjendeshin në morgun e Prishtinës/Priština. Kufomat ishin të masakruara. Burrat e familjes Ahmeti dhe Behram Fazliu u varrosën në varrezat e Likoshanit/Likošane më 3.03.1998.

**Burimet:** deklarata A.F, FDH-18020; deklarata X.A, FDH-15624; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, III, 227-229; deklarata S.A, FDH-12037; deklarata D.A, FDH-12036; deklarata N.K, FDH 36495; *Pod Lupom: Kosovojudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; KMKKRFJ, *Personat.*, FDH-10832.

### Xhemshir (Sefer) Nebihi

(1966, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë)

### Rukije (Xhezair Morina) Nebihi

(1972, shqiptare nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, dy fëmijë)

Qifti bashkëshortor Xhemshir dhe Hamide Nebihi, i kishin katër fëmijë. Me ta jetonin edhe prindërit e Xhemshirit, Seferi dhe Hate, si dhe vëllezërit Iliri dhe Zahiri. Ky i fundit ishte i martuar me Rukijen, e cila ishte në shtatzëni të vonë. Kur, në datën **28.02.1998**, nga ora 11:30, në Likos-

han/Likošane dhe **Qirez/Ćirez** filluan të dëgjoheshin breshëri të shtënash, që të gjithë familjarët ishin brenda në shtëpi, përpos Ilirit, i cili shkoi te familja fqinje Sejdiu për të mësuar çfarë po ndodhte në fshat [të shikohet regjistrimi më poshtë]. Dy helikopterë erdhën nga drejtimi i fshatit Likoshan/Likošane, fluturonin në lartësinë e ulët dhe shtënin mbi shtëpitë e familjes Nebihi. Zahiri u ngjiti në tavan të shtëpisë së re, ndërsa familjarë të tjerë kaluan në shtëpinë e vjetër. Pas dy apo tri orësh, nëntë policë erdhën në oborr duke shtënë mbi shtëpinë. I thyen xhamat e shtëpisë dhe, duke ulëritur, u urdhëruan familjarëve që të dilnin jashtë. Seferi u tha se në shtëpi gjendeshin edhe fëmijët dhe se ai dhe familjarët nuk kishin çfarë të fshehshin. Në atë çast, një polic ka shtënë mbi të dhe e plagosi. Rukija u nis drejt Seferit që t'i ndihmonte, por, në të njëjtën kohë, tre policë të tjerë kanë hyrë në dhomë dhe hapën zjarr në drejtim të qiftit bashkëshortor Nebihi. E qëlluan Rukijen në kokë duke e lënë të vdekur në vend. Më pas, e drejtuan zjarrin mbi Xhemshirit, duke e vvarë edhe atë, po ashtu, në vend.

Trupat e Rukijes dhe Xhemshirit kanë mbetur në brendi të shtëpisë deri më 3.03.1998, kur ato, së bashku me viktima dhe të rënë të tjerë që kanë humbur jetën në të njëjtën ditë, u varrosën në varrezat e Likoshanit/Likošane.

**Burimet:** deklarata H.N, FDH-15199; deklarata A.S, FDH-15198; deklarata A.S, FDH-12038; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, III, 227-229.

### Ilir (Sefer) Nebihi

(1969, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, dy fëmijë)

### Beqir (Sheremet) Sejdiu

(1971, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, dy fëmijë)

### Bedri (Sheremet) Sejdiu

(1974, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, kimist)

### Nazmi (Sheremet) Sejdiu

(1974, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, kimist)